

## VËSHTRIME – REFLEKTIM PËR KULTURËN NË KOMUNIKACION

Shkruar me dt. 29.04.2013

### 'Fëmijë-Zoti ju ruajt'

Është brengosëse niveli jo i kënaqshëm i sigurisë në rrugë. Përditë jemi dëshmitarë të këtij kaosi të krijuar veçmas pas lufte në rrugët e Kosovës, e posaçërisht në kryeqytet. Arsyetimi se si shoqëri jemi në tranzicion dhe si shtet jemi në ndërtim dhe zhvillim, është edhe me shqetësuese. Kur gjendemi në këtë kaos në rrugë dhe pengohemi duke lëvizur, çoftë si këmbësor, shofer, udhëtar apo duke shëtitur, të gjithë veprojmë për të tejzgatur këtë situatë. Gjëja e vetme e secilit prej nesh është që të fajësojë tjetrin por besa një kategori, jo edhe e vogël në krejt këtë hesap shpërthen duke sharë!

Kush është përgjegjës për lëvizjen e sigurt të nxënësve në rrugë? Mendojë se para se të gjendet një përgjigje në këtë pyetje duhet t'i kemi parasysh dy treguesit e mëposhtëm:

**E para:** Fëmijët nuk mund të jenë fajtor nëse pësojnë në aksident komunikacioni sepse thjeshtë nuk dinë se si të sillen apo t'i shmangen aksidentit. Nisur nga kjo pikë, përgjegjësia bie te prindërit, edukatorët dhe mësuesit. Ky është rezultat i mungesës së udhëzimeve dhe punës me fëmijë për sjellje të sigurt në rrugë. Pastaj përgjegjësia është te pakujdesia e ngasësve (shoferëve) të cilët nuk janë sa duhet të kujdesshëm në raport me këmbësorët posaçërisht me fëmijët. Ata detyrimisht duhet të shtojnë kujdesin e tyre gjatë ngasjes sidomos në vendbanime, në afërsi të shkollave, terreneve sportive dhe parqeve. Për shembull. 'Sikur të diskutohet me konsistence për këtë problem, një ndër pyetjet që vjen pashmangshëm është: pse nuk është radhitur te përgjegjësitë edhe infrastruktura rrugore apo (mos)puna në institucionet përkatëse?

**E dyta:** Fëmijët e shkollave fillore pësojnë më së shumti në aksidente në komunikacion, se sa prindërit e tyre. Pra, ata nuk janë fajtorë pse pësojnë në rrugë! Në të njëjtën kohë prindërit e tyre, pësojnë shumë më pak ose nuk janë fare të përfshirë në aksidente në rrugë në cilësi të këmbësorit. E ky është treguesi më i mirë i mungesës së edukimit të fëmijëve në fushën e komunikacionit. Një nga mënyrat, e besojë me efikasja është që edukimi për sjelljen në komunikacion të merrej nëpërmes mësimit cilësor dhe aktiviteteve shtesë në shkollë duke ngritur këtë çështje së paku çdo fillim të vitit shkollor.

Sa i përket aksidenteve rrugore, shifrat nga policia tregojnë ulje të aksidenteve me fatalitet në shkallë vendi. Në vitin 2012 krahasuar me vitin paraprak 2011, ka ulje të numrit të aksidenteve për afro 11 %. Po ashtu, duke ju referuar raportit të fundit vjetor të Policisë së Kosovës, në vitin e kaluar ka ulje të numrit të personave të vdekur në aksidente në komunikacion për afro 23% më pak se në vitin paraprak. Nga këto krahasime del se në vitin e kaluar është shënuar rënie në numrin e aksidenteve me fatalitet, rrjedhimisht ka më pak persona që kanë pësuar vdekje. Për këtë arritje pikë së pari duhet të krenohen ata të cilët me punën dhe angazhimin e tyre kontribuojnë në arritjen e këtyre rezultateve. Këto fakte dhe ky sukses padyshim se ndikon në rritjen e sigurisë e gjithëmbarshme të qarkullimit në komunikacion. Mediet dhe shoqëria duhet

të merren edhe me këtë ngjarje pozitive, duke e vendosur në një rrafsh tjetër dhe duke e ndarë nga zhvillimet tjera të përditshme, e shumë herë edhe negative.

Po kthehem sërish në temë duke u mundur që të justifikojë (mos) veprimet tona lidhur me këtë çështje, e cila për çdo ditë po i "vranë" pjesëtarët më të dashur të familjes tonë, të cilët edhe i japin kuptim vet fjalës familje. Shoqëria jonë dhe shteti i kësaj shoqërie, sa më shumë që të merret me këtë shqetësim, do të ofrohet më afër shoqërive dhe shteteve të zhvilluara. Ngritja e këtij shqetësimi karshi neve por edhe karshi vendeve të zhvilluara nuk do të shihet si ngecje në zhvillimin e shoqërisë tonë, por përkundrazi do të kuptohet si zhvillim i vetëdijes dhe mençuri në trajtimin e kësaj dukurie. Për më tepër, siguria e fëmijëve në rrugë është çështje globale dhe shumë brengosëse për tërë botën. Sipas raporteve të Kombeve të Bashkuara gati 1.3 milionë njerëz vdesin çdo vit në rrugët e botës dhe deri në 50 milionë janë të lënduar si pasojë e aksidenteve. Nëse kjo shifër zberthehet më tutje, në ditë ka rreth 3.500 të vdekur në rrugë në mbarë botën. Vendi ynë pa marrë parasysh që nuk është i anëtarësuar në mekanizmat dhe forumet adekuate ndërkombëtare rreth sigurisë rrugore, asgjë dhe askush nuk pengon që të punohet më tepër dhe t'i kushtohet më shumë vëmendje kësaj problematike. Zhvillimi i këtyre aktiviteteve do të vendoste vendin tonë në grupin e vendeve të cilat si fokus të shoqërisë e kanë qytetarin e vet duke e vendosur në qendër.

Nisur nga roli dhe rëndësia e të gjitha aktiviteteve që kanë për qëllim rritjen e sigurisë së fëmijëve në rrugë, këtu shihet ndonjë pronësi e dikujt se kush duhet të merret me këto punë. Nismat e tilla mund të vijnë nga të gjithë. Lëvizja e fëmijëve në rrugë është një arenë e hapur ku një pakujdesi të vogël, shpejtë mund të kushtojë me jetë. Të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion janë të barabarta me përjashtim të disa kategorive ligjore të cilat kanë përparësi në qarkullimin rrugor. Në këtë arenë, ekuilibri priset nga momenti kur dikush nga këta pjesëmarrës me veprimet e tija të padrejta rrezikon të tjerët. Zhvillimi i këtyre veprimeve të padrejta është pengesë në rrjedhën e trafikut duke vendosur në pozitë të rrezikshme pjesëmarrësit tjerë në rrugë e posaçërisht fëmijët. Fatkeqësisht fëmijët në mungesë të njohurive dhe shkathtësive janë në rrezik të përhershëm kur gjenden në rrugë. Fëmijët në këtë rast nuk mund të janë të zotë sikur që janë gjatë lojës me kompjuterë apo telefon dore në video aplikacione, ku mund të n`a sfidojnë edhe neve. Një pjesëmarrës i papërgjegjshëm duke prishur këtë ekuilibër, për një moment mund të rrezikojë seriozisht prezencën e fëmijëve në rrugë por edhe të tjerëve. Interesimi dhe marrja e masave konkrete për të zhvilluar aktivitete që kanë për qëllim rritjen e sigurisë në rrugë dhe parandalimin e aksidenteve është çështje e hapur dhe i obligon të gjithë, qofshin ata persona juridik apo fizikë të cilët kanë vullnet të mirë për të kontribuar dhe ndihmuar në rritjen e sigurisë së fëmijëve në rrugë.

Implementimi i këtyre masave konkrete do të kishte impakt pozitiv në zhvillimin e shoqërisë dhe krijimin e një ambienti më të sigurt edhe gjatë lëvizjes në rrugë. Kjo do ta radhiste vendin tonë në grupin e vendeve që brengosen për sigurinë e qytetarëve të vet në rrugë. Në anën tjetër këto veprime vlerësohen lartë edhe në forumet dhe mekanizmat ndërkombëtar. Përfshirja e moduleve të caktuara mësimore dhe aktiviteteve përcjellëse nga kjo temë do të mundësonte që edhe Kosova të prezantohej në botë me të dhënat e veta në kuadër të kësaj problematike.

Përgatitja dhe realizimi i programeve të qëndrueshme për një lëvizje të sigurt në rrugë është synim i çdo shoqërie të zhvilluar. Siguria e fëmijëve ishte brengë edhe kur ne ishim fëmijë por tash është edhe më shqetësuese. “Fëmijë-Zoti ju ruajt” kështu na thoshte babai im asokohe, sa herë që shkonim në shkollë. Fare në fund, krahas këtij urimi për fëmijët, duhet punuar të shumë për së mbari, duke mos lënë lëvizjen e fëmijëve vetëm në mëshirën e fatit.

Muhamed A. Krasniqi

Drejtor i shkollës së lartë profesionale ‘Tempulli’ në Prishtinë

meti@tempulli.org